



Komuna Progër

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Komuna Progër



Progër Commune

Local Environmental Action Plan



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



GLOBAL
ENVIRONMENT
FACILITY



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Komuna Progër

Komuna Progër



Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit:
**“Menaxhimi i Integruar
i Ekosistemit të Basenit të Prespës”**

This document is prepared in the frame of the project:
**“Integrated Ecosystem
Management in the Prespa Lakes Basin”**



GLOBAL
ENVIRONMENT
FACILITY



me mbështetjen e:
Qendra Rajonale e Mjedisit - Shqipëri
<http://albania.rec.org>



with the support of:
The Regional Environmental Center - Albania
<http://albania.rec.org>

Në bashkëpunim të ngushtë me:
Komuna Progër

In close cooperation with:
Proger Commune

me kontributin e:

with the contribution of:

Ekspertëve vendorë:
Aurel Beqo, Dhimitra Melonashi, Nardi Hoxha,
Nevruz Shkëmbi, Remzi Xhinaku, Shyqyr Çollaku.

Local experts:
Aurel Beqo, Dhimitra Melonashi, Nardi Hoxha,
Nevruz Shkëmbi, Remzi Xhinaku, Shyqyr Çollaku.

Kordinatorit vendor për PLVM:
Gjergji Tanka

Local coordinator for LEAP:
Gjergji Tanka

Ekspertëve kombëtarë:
Ferdinand Bego, Lirim Selfo,
Spase Shumka, Thimaq Lako.

National experts:
Ferdinand Bego, Lirim Selfo,
Spase Shumka, Thimaq Lako.

Stafit të projektit pranë PNUD Shqipëri:
Ardid Konomi, Eno Dodbiba, Violeta Zuna.

UNDP Albania project staff:
Ardid Konomi, Eno Dodbiba, Violeta Zuna.

Stafit të REC Shqipëri, veçanërisht:
Mihallaq Ll. Qirjo, Eduart Cani dhe Alken Myftiu.

REC Albania staff, especially:
Mihallaq Ll. Qirjo, Eduart Cani dhe Alken Myftiu.

PËRMBAJTJA

VIZIONI	7
VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE NË KOMUNË	9
1.1 Përshkrim i përgjithshëm	9
Popullsia	
1.2 Vlerësim i burimeve natyrore	11
1.2.1 Rezervat ujore	
1.2.2 Pyjet	
1.2.3 Burimet natyrore dhe larmia biologjike	
1.3 Aktivitetet njerëzore	14
1.3.1 Urbanizimi dhe infrastruktura	
1.3.2 Zhvillimi rural	
1.3.2.1 Shërbimet	
1.3.3 Të ardhurat dhe biznesi	
1.3.4 Bujqësia	
1.3.5 Blegtoria	
1.3.6 Erozioni	
1.3.7 Shëndeti i popullatës	
1.3.8 Zhvillimi i turizmit dhe edukimi qytetar	
2. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE	19
3. PLANI I VEPRIMEVE	25
Local Environmental Action Plan	
English version	35

VIZIONI

Komuna Progër, me një mjedis natyror të pasur e të larmishëm, me sipërfaqe të gjera të tokës bujqësore, sipërfaqe ujore të qeta dhe të rrjedhshme, me një peizazh të bukur, me një relief të valëzuar të ndërthurur harmonikisht mes tyre, fusha kodra, mali me veshje të pasur bimore në sajë të marrëdhënieve të qëndrueshme komunitet - mjedis do të zhvillojë ekonominë, kulturën, një infrastrukturë funksionale duke siguruar një standard jetese në rritje të vazhdueshme.

1

VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE NË KOMUNË

1.1 Përshkrim i përgjithshëm

Komuna Progër ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në pjesën veriore të fushëgropës së Devollit. Ajo kufizohet në veri me komunën e Pojanit, në jug me komunën Qendër Bilisht, në lindje me Greqinë dhe në perëndim me komunën Hoçisht.

Komuna Progër përbëhet nga 8 fshatra: Progër, Vranisht, Cangonj, Mançurisht, Pilur, Shuëc, Rakickë dhe Bickë. Nga keta, ne zone malore jane fshatrat Rakicke, Shuëc dhe Bicke. Relievi i zonës ku shtrihet komuna karakterizohet nga reliev fushor, kodrinor dhe malor.

Në territorin e komunës shtrihet një pjesë e Liqenit të Prespës së Vogël dhe kalon rrjedha e lumit Devoll. Gjithashtu ka burime të shumta të ujërave të ëmbla.

Sistemi uhor i Prespës së Vogël është sa i ndjeshëm, aq edhe kompleks, ndaj dhe koordinimi dhe administrimi i integruar i tij ka qënë një nga objektivat kryesore të Parkut Prespa që prej krijimit te tij. Sipas Planit Strategjik të Veprimit për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Parkut Prespa, i cili shtron qellimet e bashke miratuara te kooperimit trepalesh në Prespe, është nevoja të mbyllen boshlleqet në njohjen e veçorive kryesore të sistemit dhe në proceset drejtuese si çeshtje prioriteti, ndërsa ndërhyrje të rëndesishme dhe të pafavoreshme mjedisore të shkuara ose praktika aktuale duhet të restaurohen sa më shumë që të jetë e mundur ose të ndryshohen. Devijimi i Lumit Devoll në Liqenin e Prespës së Vogël, nëpërmjet të cilit pellgu i basenit të Prespës u zmadhua artificialisht, ka qënë një ndërhyrje e tillë, me ndikime të dukshme të pafavoreshme që kurrë nuk janë vlerësuar plotësisht. Nevojat për ujitjen e fushës së Korçës, për të cilën u zbatua devijimi në vendin e mësipërm, nuk kanë qënë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe në aspektin teknik.

Sipërfaqja e tokës është e ndarë në 5 zona nga kategoria e tretë deri tek e shtata të ndara si më poshtë:

- Kategoria e tretë 304 ha
- Kategoria e katërt 782 ha
- Kategoria e pestë 206 ha
- Kategoria e gjashtë 395 ha
- Kategoria e shtatë 62 ha

Popullsia

Komuna Progër ka një popullsi të përgjithshme prej 6060 banorë. Moshë mesatare e popullsisë është 46 vjet dhe e ndarë sipas fshatrave është si më poshtë:

Fshati	Nr. i banorëve
Progër	1005
Mancurisht	780
Cangonj	1319
Pilur	915
Vranisht	1425
Bickë	171
Rakickë	235
Shuec	210

Në periudhën e tranzicionit ka patur lëvizje demografike, emigracioni për jashtë shtetit, lëvizjet e popullsisë brenda vendit, etj.

Ndërkohë që migrimi është i stabilizuar vitet e fundit dhe numri i familjeve që vijnë dhe largohen është 3-4 në vit.

1.2 Vlerësim i burimeve natyrore

1.2.1 Rezervat ujore

Në rezervat ujore të Komunës Progër mund të përmendim: burimet e Mançurishtit, (izvoret), burimet e Progrit, lumin Vranisht, pjesën e liqenit të Prespës të Vogël në afërsi të fshatrave Zagradec dhe Shuec, si dhe një segment i lumit Devoll që kalon në territoret e Komunës Progër. Gjendja mjedisore, mënyra e administrimit dhe përdorimit të këtyre rezervave ujore është tejet e përkeqësuar, sidomos pas vitit 1976, kur një pjesë e rrjedhjes së Lumit Devoll u devijua në basenin e Liqenit të Prespës së Vogël. Si pasojë e kësaj ndërhyrjeje dhe e mungesës së zgjidhjeve teknike, sasisa e depozitimeve në liqen tashmë paraqitet në nivele katastrofike. Pjesa e hapur e ujërave liqenore është tejet e reduktuar dhe vegjetacioni me dominim të kallamishteve tashmë e ka pushtuar atë. Në një situatë të tillë çënimet ndeshen edhe ndër elementët e florës dhe faunës native.

Vlerësimet e mëparëshme të vëllimit të sedimenteve të depozituara në Prespën e Vogël (për shkak të devijimit të lumit Devoll) ishin 1.2 milion m³.

Megjithatë, analiza e rrjedhjes së ngurtë në studimin prezent vlerëson volumnin e devijuar në Liqen në 19% të rrjedhjes totale vjetore të lumit dhe normën e rrjedhjes së ngurte të lumit Devoll në 1694 t/km²/vit, që rrit volumnin e sedimenteve të depozituara në 1.98 milion m³ për një periudhë 25-vjecare të devijimit. Kjo vlerë përfshin gjithashtu sedimentet e depozituara në kanal midis pikës së devijimit dhe Liqenit.

Ky depozim masiv i sedimenteve ka provokuar një ndikim të qënësishëm në karakterin, cilësitë mjedisore dhe funksionimin e habitateve, nga një liqen i cekët në një moçalishte të dominuar nga shtrirja emergjente e vegjitacionit. Devijimi i Devollit ka përshpejtuar kështu efektin e stazhit natyral (mbushjen) të shquar në Liqen për disa qindra vjet ose më shumë.

Menaxhimi i ujërave nuk është i organizuar në nivel komune, por kryhet në nivel qarku. Sidoqoftë gjendja e menaxhimit të tyre lë për të dëshiruar. Duke veçuar dy zona që kanë statusin e zonave të mbrojtura, mund të themi se menaxhimi është i kënaqshëm për Rezervatin e Cangonjit dhe problematik për pjesën që gjeografikisht i përket teritorit të komunës sonë dhe është tërësi e Parkut Kombëtar Prespa.

Peshkimi si aktivitet, krahasuar me vite më parë edhe pse vijon që të ushtrohet, për shkaqe të përshkruara më sipër të situas në Liqen tashmë përbën një sektor ekonomik me peshë të vogël në Komunë. Aktualisht nuk ka ndonjë nismë për zhvillim akuakulture në zonë. Një trajtim i integruar i sistemit ujqor Prespë e Madhe Prespë e Vogël do të përfshinte në skemën e ripopullizimit me krap autokton edhe të këtij trupi ujqor.

1.2.2 Pyjet

Në komunën Progër, sipërfaqja më e madhe pyjore ndodhet në pjesën perëndimore të Malit të Moravës, si dhe në pjesën lindore në Malin e Ivanit. Sipërfaqja që zënë pyjet është 750 ha ose 25% të sipërfaqes totale të territorit të komunës. Prerja pa kriter, mbikullotja dhe zjarret e herëpashershme në vitet e fundit ka bërë që shpyllëzimi të mbetet një nga problemet kryesore që shqetëson komunitetin.

Në Komunën Progër, llojet e pishës, bredhit, dëllinjave të ndryshme gjenden kryesisht në pjesën e vargmalit të Moravës. Llojet e pishës kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit si dru i lartë. Specifike për komunën Progër janë gështenja e butë, e kultivuar në fshatin Vranisht, akacia që është një bimë e introduktuar dhe me areal relativisht të vogël, si dhe bushi dhe llojet e dushqeve (*Quercus petraea*, *Quercus cerris*, *Quercus pubescens* etc) në anën e malit të Ivanit> Disa lloje drunorë kanë mundësi të mëdha për tu destinuar për prodhime të ndryshme artistike, si, siç është bushi (*Bucsus semprevirensis*). Ndër bimët e ulëta mund të përmendim lloje të mikroflorës akuatike, lloje likenesh, myshqesh dhe fiernash, ku përmendet prania e shpeshtë e fiershqipes. Ka tendenca pozitive të trajtimit, menaxhimit dhe ruajtjes të tyre.

1.2.3 Burimet natyrore dhe larmia biologjike

Në territorin e komunës të Progrit ndodhen dy zona që kanë statusin e Zonës së Mbrojtur: Rezervati Natyror i Cangonjit dhe një pjesë e Parkut Kombëtar të Prespës, por në qoftë se për të parin ky status është i vërtetë dhe funksionon zbatimi i tij, për pjesën e Parkut të Prespës shumë pak është punuar për zbatimin në praktikë të këtij statusi.

Ligatinat e Prespës dhe Devollit përfaqësohen kryesisht nga sipërfaqet e hapura ujore, kallamishtet, ujra rrjedhëse, tranzitore dhe kullotat e lagura. Kullotat e lagura janë pjesë të hapura të liqenit (pa kallamishte) që janë nën ujë kryesisht gjatë pranverës dhe verës. Ato ofrojnë mjedise për riprodhimin e peshqëve dhe amfibëve, vende për ushqimin e mjaft shpendëve ujorë dhe burime shumë të rëndësishme për banorët vendas.

Liqeni i Prespës së Vogël edhe përtej cënimeve mjedisore vijon të jetë strehë ellojeve të rëndësishëm faunistikë ujorë si: mrena (*Barbus prespensis*), lloj i përfshirë në Aneksin II të Direktivës 92/43/EEC dhe në Aneksin V të Direktivës 92/43/EEC, cirona e vogël (*Alburnoides bipunctatus prespensis*), lloj i përfshirë në Aneksin II të Direktivës 92/43/EEC, cironka (*Calcalburnus belvica*) etj.

Kurse llojet: *Paraphoxinus epiroticus* lloj i përfshirë në Aneksin II të Direktivës 92/43/EEC dhe *Rutilus prespensis* lloj i përfshirë në Aneksin II të Direktivës 92/43/EEC janë endemike të gadishullit ballkanik, dhe në bazë të të dhënave për pjesën Greke të Prespës janë taksonë të pranishëm në këtë ekosistem.

Vlen të theksohet se alternimet mjedisore kanë sjellë krijimin e kushteve për zhvillimin e llojeve aliene si tinka (*Tinca tinca*), peshku i artë (*Lepomis gibbosus*) që tashmë ka marë vlerat e një lloji invaziv, karasi (*Carassius auratus*) etj.

Liqeni i Prespës së Vogël dhe pjesë të veçanta të shtratit lumor të Devollit janë habitate interesane për gjitarin lundërza (*Lutra lutra*), një element faunistik me mjaft vlera për tu marrë në konsideratë mbrojtjeje.

Në territorin e komunës Progër gjenden, por janë në pakësim e sipër, fazani, derri i egër, thëllëza, pëllumbi i egër, etj. Ekzistojnë shpendë të zakonshëm si mëllenja, zgarbulli, bilbili, qukapiku, turtulli shtegtar, pupa, skifteri dhe shtegtarë të tjerë si lejleku, dallëndyshja etj. Në lumin e Devollit gjenden disa lloje peshqish, gaforre, ngjala dhe, në afërsi të tij, pata dhe rosa të egra, lundërza, etj. Në pyjet në territorin e komunës gjenden ariu, ujku, dhelpra, kunadhja, sorkadhja si dhe zvarranikë të tokës, si hardhuca dhe zhapiku i gjelbër, nepërka e malit, etj.

Disa nga këto gjallesa janë të përfshira në listën e llojeve të rrezikuar, ku mund të përmendim fazanin, derrin e egër, sorkadhen, që kryesisht rriten në malin e Moravës dhe në Rezervatin e Cangonjit. Gjithashtu, disa lloje peshqish të liqenit të Prespës së Vogël janë të rrezikuar si pasojë e procesit të kënetëzimit të liqenit.

Zona është e pasur në resurse bimësh mjeksore të tilla si: lule kuqja (*Papaver rhoeas*), salepi (*Orchis*

mascula), mullaga (*Malva sucvestris*), dëllinja e kuqe (*Juniperus ohycedrus*), lule ballsani (*Hyperikum perforatum*), murrizi (*Crataegus monogyna*), kamomili (*Chamomolla recutita*), mështekna (*Betula pendula*), çaji i malit (*Sideritis roeseri*), trëndafili i egër (*Rosa kanina*), manaferra (*Rubus fruticosus*), gorica (*Pyrrus amygdaliformis*) dhe hithra (*Urtica dioica*).

Një pjesë e këtyre bimëve përdoren drejtpërsëdrejti nga njerëzit për mjekimin e disa sëmundjeve. Grumbullimi dhe shitja e këtyre bimëve është kthyer në një burim të sigurimit të të ardhurave për një pjesë të mirë të banorëve të zonës. Grumbullimi i tyre kërkon një kujdes të veçantë dhe kontroll rigoroz nga autoritetet në mënyrë që ajo të behet me kritere agro teknike që të mos rrezikojë zhdukjen e tyre.

Me zhvillimin ekonomik-shoqëror të zonës, pejsazhi është në ndryshim të vazhdueshëm. Shtimi i numrit të drurëve frutorë, përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i sistemeve të reja të ujësjellësve e kanalizimeve, etj, janë disa nga aspektet pozitive të këtyre ndryshimeve, ndërkohë që disa nga efektet negative për pejsazhin janë shpyllëzimi dhe prerjet abuzive dhe pa kriter, territoret e djegura nga zjarret në pyje, kënetëzimi i liqenit të Prespës dhe mosgrumbullimi dhe përpunimi i mbetjeve urbane.

Shpella e trenit

Vlerë e rrallë natyrore dhe historike

Shpella e Trenit është një kombinim i rrallë i vlerave natyrore dhe materialo-shpirtërore. Ajo ndodhet në buzë të Liqenit të Prespës së Vogël, përfund një kodre të vogël pranë fshatit Tren, në Grykën e Ujkut, 706 m mbi nivelin e detit. Është formuar nga procesi i karstit, pra nga tretja prej ujit e shkëmbinjte gëlqerorë të Trias-Jurasikut, të cilët janë kapur nga disa shkëputje tektonike gjatë Pliocen-Kuaternarit. Shkëmbinjte janë tepër të copëtuar nga shkëputjet tektonike, të cilat sollën fundosjen e Prespës së Vogël, ku u krijua liqeni me të njëjtin emër. Ujërat që kanë formuar shpellën, kanë shfrytëzuar një shkëputje të tillë tektonike.

Relievi është kodrinor, e përreth shpellës malor, rreth 1400-1500 m mbi nivelin e detit (maja e Golinës, 1465 m) në malin e Ivanit. Banorët e njohin dhe me emrin Shpella e Skordilevës.

Ka disa galeri, por më e madhja është ajo e Liqenit: 40 m e gjatë dhe 5,50 m e gjerë. Në të janë gjetur qindra Rinolofidi, pasi korenti ajrit me hyrjen e shpellës dhe prania gjithnjë e ujit krijojnë kushte të përshtatshme. Në pjesën perëndimore të kodrës ku ndodhet Shpella e Trenit gjatë hapjes së një gurorjeje u zbulua një tjetër shpellë. Nga sa e njihet deri tashti, galeria e saj kryesore duhet të lidhet me Shpellën e Trenit: me sallën A. Ajo ka shumë kongregacione të bukura. Ndonëse shpërthimi i eksplozivit në gurorë i kanë sjellë dëme stalagmiteve e stalagmiteve, ende vlerat e shpellës, ruhen mirë.

Shpella e Trenit zë vend kryesor në tërësinë e monumenteve arkeologjike, në fushën e Devollit e pellgun e Korçës. Si vendbanim prehistorik është bërë e njohur për herë të parë në vitin 1952, nga vëzhgimet e H. Ceka e S. Anamali. Pasuritë ujore, pyjet e dendura, kafshët e egra dhe fushat pranë saj me toka pjellore, ishin kushtet më kryesore që kushtëzuan vendosjen e banorëve prehistorikë në shpellë.

Shpella e Trenit është një shpellë shumë e rëndësishme për lakuriqët e natës, sidomos gjatë periudhës së verës dhe vjeshtës. Nga një vlerësim i përafërt, brenda shpellës takohen gjatë verës rreth 2000-2500 individë lakuriqesh nate, të dominuar nga lloji globalisht i rrezikuar *Miniopterus schreibersi*, i cili përbënte rreth 90% të numrit të lakuriqve të kësaj shpelle, duke qenë kështu shpella më e rëndësishme e njohur deri tani në vendin tonë për këtë lloj lakuriqi nate. Lloje të tjerë shoqëruar lakuriqesh nate të kësaj shpelle janë: *Rhinolophus ferrumequinum*, *R. blasii*, *Eptesicus serotinus*, *Myotis capaccinii*, *M. daubentoni*, *M. myotis*, *M. blythi* dhe *Pipistrellus savii*. Kjo shpellë është gjithashtu e rëndësishme edhe për llojin *Myotis daubentoni*, i cili deri më sot është sinjalizuar në vendin tonë vetëm në rajonin e liqeneve të Prespës.

1.3 Aktivitetet njerëzore

1.3.1 Urbanizimi dhe infrastruktura

Për të gjithë fshatrat e komunës ekzistojnë plane rregulluese të viteve 1980 - 1984. Plane rregulluese të viteve të fundit, që t'i pershtaten zhvillimit të zonës, nuk ka dhe për ndërtime të reja punohet me plane rregulluese pjesore.

Ndërtesat e banimit në komunë janë 1805 nga të cilat njëkatëshe 1024 dhe 281 ndërtesa 2 katëshe.

Sistemi rrugor në komunë është i kategorive rurale dhe kombëtare. 1025 m është e asfaltuar, ndërsa tjetra e pa asfaltuar gjë që përbën problem në dimër për fshatrat Rakickë dhe Shuec, ndërsa të tjerat kane probleme në periudhen e verës në kohën e thatësirës ku problem shqetësues është pluhuri

Në territorin e komunës ka një shkollë të mesme që ndodhet në f Progër, si dhe shkolla 9-vjeçare në fshatrat Rakickë, Cangonj, Vranisht, shkollë fillore në fshatrat Mançurisht e Shuec, qendra shëndetësore në fshatrat Progër, Vranisht, Cangonj, Pilur, Mançurisht.

1.3.2 Zhvillimi rural

1.3.2.1 Shërbimet

Të gjithë qendrat e banuara në fshatrat e komunës kanë akses në sistemin sanitar të ujit të pijshëm. Furnizimi me ujë në fshatrat Pilur, Bickë, Vranisht, Cangonj kryhet me rrjedhje të lirë, kurse në fshatrat Progër, Mançurisht, Rakickë dhe Shuec furnizimi kryhet me ngritje mekanike. Prurjet e ujit janë të mjaftueshme, por problem mbetet rrjeti shpërndarës i fshatrave që është shumë i amortizuar nga koha e gjatë e përdorimit si dhe nga ndërhyrjet e paligjshme në rjet. Zgjidhja e problemit mbetet zbatimi i projekteve për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

Sistemi i kanalizimeve i ujërave të zeza është i rregullt dhe i ndërtuar në vitet e fundit, Me perjashtim të fshatrave Pilur dhe pjeserisht Progri fshatrat e tjera nuk kanë kanalizime të ujrave të zeza. Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza është një problem akut dhe që kërkon zgjidhje të menjëhershme pasi ka ndikim negativ në mjedis, sidomos në cilësinë e ajrit dhe pasoja në shëndetin e njerëzve. Gjendja në fshatrat, ku nuk është ndërhyrë është në përkeqësim të vazhdueshëm.

Asnjë nga fshatrat në komunë nuk ka sisteme të trajtimit të ujërave të zeza. Largimi nga qendrat e banuara bëhet në mënyrë private nga vetë banorët.

Mbetjet e ngurta

Në komunë krijohen mbetje nga veprimtarit familjar të përditshme si dhe mbetje të tjera të ngurta nga aktivitete ndërtimore që lidhen me rinovimet e banesave dhe prodhimin e gëlqeres. Llogaritja e mbetjeve të ngurta është në shifren 7,2 ton në ditë. Për sa i përket sistemit të grumbullimit të mbetjeve, për çdo njësi administrative janë caktuar vendet e grumbullimit të tyre, si dhe janë vendosur për çdo fshat nga një karrocë për heqjen e mbeturinave familjare.

Problem mbetet vendi i depozitimit dhe i përpunimit. Mungesa e një vendi të përshtatshëm depozitimi dhe trajtimi për mbetjet e ngurta bën që gjendja të jetë në përkeqësim të vazhdueshëm me pasoja për ndotjen e mjedisit.

Furnizimi me ujë

Furnizimi shtëpiak me ujë mbulohet kryesisht nga uji nëntokësor, ndërsa ujitja mbulohet nga uji sipërfaqësor dhe shërbehet nga infrastruktura e përbërë nga rezervuare të vegjël të shumta ujitës në vendet malore, veprat e rregullimit gjatë lumit, dhe një rrjet ujitës ekstensiv dhe drenimi me kanale të hapur, veçanërisht në fushën e Korçës.

Kërkesa për ujë në zonë është llogaritur në një total prej 100.78 million m³/vit, me kërkesën në ujitje të dominuar në 84.35 million m³ (kërkesa për një ha tipik të ujitur u llogarit në 3500 m³/vit). Kapaciteti akumulues prej 47 milion m³ i rezervuarëve egzistues ujitës shpie në një deficit mesatar vjetor të ujit për bujqësinë të 39.2 million m³. Ky deficit mund të ulet përafërsisht në 13.8 million m³ nëse merret në konsideratë teprica e ujërave nëntokësore (25.42 million m³). Megjithatë, kjo nuk rekomandohet të paktën para se të përdoret i gjithë potenciali sipërfaqësor, meqë mendimi ekspert favorizon ruajtjen e shtresave ujëmbajtëse për nevojat e ujit të pijshëm.

Tabela . Kërkesa për ujë e vlerësuar në zonën e studimit

Siperfaqja	Shperndarja e kërkesës (10E3 m ³ /vit)				Totali (10E3 m ³ /vit)
	Ujitja	Blektoria	Shtëpiake	Turizmi, Industria	
Devulli i Siperem	13,227	458	2,236	2	19.923
Devulli Qendror	71,123	1.379	12,347	8	84.857
Shuma	84,350	1.837	14,583	10	100.780

1.3.3 Të ardhurat dhe biznesi

Numri i të punësuarve, në vitin 2007, është 27,3 % e popullsisë. Sipas sektorëve numri i të punësuarve është: në sektorin shtetëror janë punësuar 2,7% e popullsisë, në sektorin privat janë punësuar 1,6 % e popullsisë, të vetëpunësuar në bujqësi 23 %.

Të ardhurat e popullsisë sigurohen nga vetëpunësimi në bujqësi, nga emigrimi dhe nga punësimi në sektorin shtetëror.

Në komunën Progër ka 60 biznese që zhvillojnë aktivitetin e tyre. Këto ndahen në aktivitete tregtare si bare, dyqane, farmaci, etj., dhe aktivitete prodhuese si baxho, zdrukhtari, etj.

Bizneset problematike me ndikim negativ në mjedis janë linjat e prodhimit të gëlqeres dhe të inerteve në fshatin Progër.

Numëri i familjeve që punojnë në gurore nga fshati Progër është 15.

1.3.4 Bujqësia

Nga totali i tokës bujqësore prej 2277 ha, 1749 ha është tokë e ndarë e punueshme, diferenca është tokë e abandonuar dhe e refuzuar

Toka bujqësore, aktualisht, përdoret për pemëtari (45%), për kultivimin e bimëve prashitëse (30%) dhe drithëra (25%). Megjithatë vihet re një tendencë në shtimin e sipërfaqes që përdoret për pemë frutore.

Rendimentet aktuale mesatarisht janë 400 kv/ha për pemëtarinë dhe 35 kv/ha për drithërat. Këto nivele prodhimi pritet që të rriten, pasi tendenca e fermerëve të zonës është për rritjen e numrit të mjeteve të mekanikës bujqësore dhe përdorimit të plehrave kimike.

Pjesa dërmuese e popullsisë i është kushtuar bujqësisë 95 %. Përfitimet ekonomike për familje në vit nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale arrin mesatarisht në 4000-5000 dollarë. Këto të ardhura kanë tendencën për t'u rritur, pasi fermerët po përqendrohen në kultivimin e një kulture bujqësore, ku dhe efënca në prodhim mund të jetë më e madhe.

Aktualisht, kimikatet në bujqësi përdoren në një masë të konsiderueshme dhe tendenca është në shtimin e përdorimit të tyre, jo vetëm në bujqësi, por dhe në pemëtari. Kjo, natyrisht, do të ndikonte negativisht në mjedis, në bletari dhe në prodhimin e bio-produkteve.

1.3.5 Blegtoria

Ky aktivitet nuk është më prioritet i banorëve të zonës. Aktualisht, numri i familjeve që merren me blegtori është rreth 15 dhe numri i krerëve të bagëtive të trasha është 850 dhe i të imtave 2430 krerë. Tendenca është për heqjen dorë nga blegtoria si aktivitet, duke zvogëluar ndjeshëm numrin e personave që merren me këtë fushë.

1.3.6 Erozioni

Erozioni, në tërësi, nuk është një problem shqetësues, duke përjashtuar disa zona të veçanta të tokave bujqësore, përgjatë rrjedhës së lumit Devoll në fshatrat Progër Mançurisht dhe Cangonj, ku humbja e sipërfaqes së tokës, edhe pse është e vogël, ekziston si problem.

Përmbytjet janë problem me shtrirje të kufizuar në fshatin Vranisht (lumi me të njëjtin emër kalon në mes të fshatit) dhe në disa sipërfaqe toke bujqësore në anë të lumit Devoll. Nuk ka ndonjë sistem të përcaktuar mbrojtjeje nga përmbytjet. Sidoqoftë, gjendja e problemit është e qëndrueshme.

1.3.7 Shëndeti i popullatës

Shëndeti i popullsisë është i qëndrueshëm, por me problemin e ujërave të zeza dhe mbetjeve urbane rreziku është prezent. Megjithatë, rastet e sëmundjeve infektive, të ndodhura gjatë 5 viteve të fundit janë të rralla. Probleme të ndotjes, të shkaktuara nga aktivitete të ndryshme, në rajon nuk ka. Kapacitetet administrative dhe burimet njerëzore në këtë fushë janë të mjaftueshëm.

1.3.8 Zhvillimi i turizmit dhe edukimi qytetar

Në komunën Progër nuk zhvillohet aktiviteti turistik, ndaj në të gjithë komunën mungon një infrastrukturë apo shërbim i tillë.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit

Në komunën Progër kanë vepruar dhe veprojnë organizata zhvillimi dhe donatorë të ndryshëm si REC, USAID, UNDP, SIDA, SNV, AMPEP etj., të cilat kanë mbështetur një sërë aktivitete në sektorë të ndryshëm: arsim, mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit, zhvillimin e zonës, por dhe ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit në këto drejtime. Megjithatë, në komunë nuk ka veprimtari aktive të shoqërisë civile lokale, që mund të veprojnë si në ndërgjegjësimin e komunitetit ashtu dhe për gjenerimin e fondeve.

Në fushën e edukimit mjedisor, e vetmja kurrikul, që përmban një edukim të gjerë dhe me elementë bashkëkohor të edukimit, është "Paketa e Gjelbër" e përgatitur nga REC Shqipëri. Kjo paketë mësimore përdoret kryesisht në klasën e 7-të dhe përbën një mundësi të madhe si për nxënësin ashtu dhe për mësuesin.



Identifikimi i problemeve

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë fizike dhe njerëzor)	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket (Numri i banorëve ose përqindja e popullsisë së prekur)	Ndikimi (Paraqet ndikimin negativ në: Mjedis, Shëndët, Mirëqenie, tjetër të identifikuar)	Prioritarizimi (I matur me shkallën: * = Pak i rëndësishëm ** = Mesatarisht i rëndësishëm *** = Shumë i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhershme)
1 - UJI					
1. Liqeni - kënetëzimi i liqenit të Prespës së Vogël	- Futja për një kohë të gjatë e Lumit të Devollit në të	E lartë	440 banorë	-Cënime të ekuilibrave kryesore të ekosistemit -Shkatërrimi i vendeve të shtimit të peshkut -Shkatërrimi pejsazhit -Përkeqësimi i cilësisë së ujit -Favorizimi i kushteve për përhapjen e llojeve aliene të florës dhe të faunës	* * *
2- Përmbytjet nga lumi Devoll i tokave bujqësore në periudhën e prurjeve maksimale	- Mungesa e sistemit të mbrojtjes - Devijimi i shtratit në kohe me reshje - Hedhja e mbetjeve urbane ka sjellë si pasojë, në vende të ndryshme, ngushtimin e shtratit dhe si pasojë rritjen e shpejtësisë të rrjedhjes.	E ulët	3108 banorë	- Shkatërrimi i strukturës të tokës dhe fenomeni i shpëlarjes së saj - Shkatërrimi i prodhimeve bujqësore	*


3- Ndotja e theksuar e segmentit të shtërimit të lumit Devoll që kalon në fshatrat Mançurisht, Cangonj, Progër.	- Hedhja e mbetjeve familjare dhe atyre të ngurta - Shkarkimi i ujërave të zeza e të bardha	E lartë	Banorët e fshatrave Mançurisht Cangonj Progër	- Rritja e rrezikut të sëmundjeve infektive. - Ndotja e mjedisit në anën e lumit - Prishja e cilësisë së ujit të lumit - Ndotja e ajrit	**
4 - Rrjeti i kanaleve ujitës - Prishja e kanaleve të rrjetit ujitës	- Mosfunksionimi i sistemit ujitës - Mosmirëmbajtja prej ndërmarrjes së ujërave.	E ulët	4500 banorë	- Ulet efektiviteti i investimeve të kryera në sistemin ujitës. - Ulen të ardhurat nga sektori i bujqësisë (Rendimente të ulëta, mbjellje e kulturave që nuk kanë rritje intensive)	**
5- Ujërat nëntokësore në pakësim e thellim. - Ushqimi nëntokësorë reale i ujërave nëntokësore prej reshjeve atmosferike.	- Shkatërrimi i pyjeve, prezenca e sipërfaqeve të pjerrëta të zhveshura, shkakton rrjedhje sipërfaqësore në liqen dhe intensifikon erozionin - Sasia e reshjeve të shiut nën mesataren shumëvjeçare në vitet e fundit.	E mesme	6060 banorë	- Pakëson rezervat ujore	**
2 - AJRI					
1- Ndotja e ajrit me gazra të dëmshëm dhe si amoniak, dioksinë, etj.	- Djegia e mbeturinave familjare sidomos atyre plastike - Çlirim i gazrave nga jashtëqitjet e bagëtive (të pambuluara). - Avullime nga rrjeti i zbuluar i ujërave të zeza	E lartë	6060 banorë	- Mund të shkaktoje dëmtime në shëndetin e banorëve, për shkak të rritjes së mundësisë së infeksioneve të ndryshme. - Ndotje e ajrit në zonën e banuar.	***
2- Ndotja e ajrit nga pluhurat	- Mosasfaltimi i rrugëve të fshatrave të komunës	E ulët	6060 banore	-Krijimi i pluhurave ndikon tek shëndeti i banorëve - Demtohet mjedisi perreth	**

3 - TOKA						
1-Gërryerjet dhe prania e dukurisë së erozionit në tokat bujqësore pranë lumit Devoll	-Prurjet në muajt e vjeshtës dhe të dimrit -shfrytëzimi për nxjerrjen e materialeve të ndërtimi dhe marrja e rërës nga lumi	I ulët	3000 banorë	- Ndikimi në prodhimin bujqësor - Ndikimi në pejzazh -Ndikimi në përkeqësimin e cilësisë së ujit	*	
2- Pakësimi i tokës bujqësore prej tjetërsimit të saj për ndërtime	- Ndërtime pa plane urbanistike dhe në tokat bujqësore sipas dëshirës së individit. - Mungesa e planeve rregulluese për zonat e banuara	E mesme	2000 banorë	- Ulen të ardhurat për frymë. - Ndotja e mjedisit si rezultat i shkarkimit të ujërave të zeza e te bardha. -Cënime të habitateve për lloje të caktuara floristike dhe faunistike	**	
3- Përdorim jo racional e abuziv i tokës truall.	- Mungesa e një plani rregullues për çdo fshat. - Niveli i ulët i zbatimit të ligjit dhe mungesa e masave shtrënguese	E lartë	6060 banorë	- Shkaktohet një masakër urbanistike - Prishet infrastruktura rrugore - Ndotet mjedisi nga mungesa e sistemit te kanalizimit të ujërave të zeza	**	
4. Manaxhimi jo i qendrueshem i mbetjeve urbane	-Mungese e fondeve - Mungesa e studimeve për përcaktimin e venddepozitimeve sanitare për mbetjet urbane dhe venddepozitimeve për inertet nga aktivitetet ndërtimore dhe prodhimi i gëlqeres	E lartë	6060	-Ndotje ne ritje e mjedisit, përfshirë ndotjen e ajrit, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore	***	

4. BIOSFERA						
1- Gjendja e dëmtuar e pyjeve të dushkut si dhe dëmtimet në pishë apo në bredh në afërsi të fshatrave. Prerja abuzive e pyjeve dhe rënia e zjarreve	- Prerja të paligjshme nga komuniteti për dru zjarri e për gjeth. - Kullotja pa kriter -Zjarret	E lartë	6060 banore	- Dëmtohet rëndë ekosistemi pyll dhe ai nuk kryen funksionet e veta prodhuese, mbrojtëse, rekreative , etj. - Dëmtohet biodiversiteti, varfërohet veçanërisht fauna. -Cënohen ekulibran e ndërveprimet midis mjediseve tokësore dhe ujore	***	
2- Mungesa e një strategjie për përmirësimin në pyjet e dushkut	Mungesa e fondeve	E mesme	3100 banorë	- Mungesa e planit të mbarështimit të pyjeve komunale. - Rënie e fuqisë llstarizuese të pyllit	**	
3 - Mosrespektimi i statusit të zonave të mbrojtura prej komunitetit	- Njohja e dobët ose mosnjohja e vlerave të zonave të mbrojtura, nga komuniteti. -Kapacitetet e ulta të administrimit të strukturave përgjegjëse për Zonat e Mbrojtura, Ujtar etj. -Mbivendosja e kompetencave	E mesme	6060 banorë	- Dëmtimi i florës dhe i faunës. - Zbehja e vlerave ekologjike, të biodiversitetit.	**	
4- Mungesa e një studimi të plotë për gjendjen aktuale dhe masat për mbrojtjen e llojeve të rrallë dhe atyre të rrezikuar.	- Mungesa e fondeve të nevojshëm për një studim të tillë.	E lartë	6060 banorë	- Dëmtimi i habitateve - Mungesa e një strategjie për ruajtjen e biodiversitetit.	***	

5- Pakësimi në mënyrë të ndjeshme i llojeve që përbëjnë faunën në këtë rajon	- Gjuetia e paligjshme - Puna e dobët e personelit pyjor -Ndërhyrjet në ekosisteme (pyjore dhe akuatike)	E lartë	6060	- Dëmtimi i habitateve -Kërcënim për zhdukje për mjaft lloje floristike dhe faunistike	***
5. MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK					
1- Përkeqësimi i vazhdueshëm i rezervës peshkore nga gjuetia e paligjshme perfshire përdorimin e mjeteve plasëse	- Mosfunksionimi i ligjit - Puna e pamjaftueshme e organeve përgjegjëse.	E mesme	440 banorë	- Dëmtim i florës e faunës ujore. - Dëmtimi i llojeve të rralla	**
2- Mungesa e planeve rregullues për fshatrat	- Mungesa e burimeve financiare	E mesme	6060 banorë	- Ndërtime në mënyrë të paligjshme - Mungesa e mjedisit të kulturuar e komod në zonat e banuara. - Mungesa e perspektivës së zhvillimit.	**
3- Pamjaftueshmëria e ujit të pijshëm në fshatrat Vranisht, Pilur dhe Bickë	-Mosshfrytëzimi i kapaciteteve ujore -Rrjeti i brendshëm i dëmtuar -Ndërhyrjet dhe përdorimi për qëllime të tjera si ujitje	E lartë	3500 banorë	- Rritja e mundësisë për t'u prekur nga sëmundjet - Ndikim negativ ne nivelin e jeteses të komunitetit	***
4- Mungesa e kanalizimit të ujërave të zeza në gjashtë fshatra të komunës me përjashtim të Progrit dhe Cangonjtit	- Mungesa e projekteve dhe studimeve për këtë qëllim - Lënia pas dore e organeve të qeverisjes vendore	E lartë	4100 banorë	- Rrezik i mundshëm për sëmundje infektive - Ndikim negativ ne nivelin e jeteses te komunitetit	***
5- Ndotja e ajrit nga linjat e prodhimit të gëlqerës dhe të materialeve inerte	- Mungesa e filtrave për këto linja prodhimi sipas teknologjive bashkëkohore	E lartë	1800 banorë fshati Progër	- Rrezik për sëmundje - Ndotje e ajrit me pasoja ne mjedis	***

<p>6- Mungesa e studimeve ne zone për sigurimin e energjisë nga burime të tjera si era, panele diellore, etj</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërgjegjësimi i komunitetit -Mosangazhimi i institucioneve pergjegjese - Mungesë e fondeve 	<p>E mesme</p>	<p>6060 banorë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritje e nivelit të jetesës - Mjedis më i pastër 	<p>**</p>
<p>7- Edukimi i pamjaftueshëm mjedisor</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e edukimit mjedisor në të gjitha nivelet 	<p>E mesme</p>	<p>Për të gjithë nxënësit e shkollave</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndikon negativisht në edukimin e përgjithshëm mjedisor të komunitetit. 	<p>**</p>



3

Plani i Veprimeve

Problemi (Problemi merret nga matrica e problemeve, të cilat janë identifikuar në fazën e parë)	Veprimet (Paraqet listën e veprimeve konkrete që duhet të ndërmerren për zgjidhjen e problemit në fjalë. Mund të jenë 1 ose disa aktivitete)	Prioriteti (i matur me shkallën (I matur me shkallën : *-Pak i rëndësishëm **-Mesatrisht i rëndësishëm. ***_Shumë i rëndësishëm Afati kohor (I matur me shkallën: (Afat shkurtër(deri 5 vjet) Afat mesëm deri 10vjet Afat gjatë deri 15 vjet	Aktorët përgjegjës dhe bashkëpuntorët e mundshëm (Mund të jene institucionet që janë direkt përgjegjës për problemin si dhe aktorë të tjerë në rolin e bashkëpunuesit)	Kostoja E përafërt (Vlera në jepet në Lekë, përveç ku specifiko-het ndryshe)	Efekti (Një pershkrim i efektit pozitiv që vjen nga zgjidhja e këtij problemi)
1 - Uji					
1- Liqeni - kënetëzimi i liqenit të Prespës së Vogël	1-Ndalimi i futjes të lumit Devoll në liqenin e Prespës së Vogël. 2- Pastrimi i liqenit nga mbetjet e grumbulluara	*** Afatgjatë	- Pushteti qendror - Institucione donatore ndërkombëtare	200.000.000	- Riftingu i vlerave mjedisore të rajonit - Ndalimi i humbjes së biodiversitetit përfshirë peshkun - Ndikim klimatik në rajon
2- Përmbytjet nga lumi Devoll i tokave bujqësore në periudhën e prurjeve maksimale	1- Ndalimi i marrjes së inerteve nga lumi Devoll 2- Devijimi i shtratit në vende me rrezik përmbytje 3- Ndalimi i hedhjes të mbetjeve urbane dhe inerteve në shtratin e lumit	** Afatshkurtër	- Komuna - Pushteti qendror	7.000.000	- Ndalimi i erozionit të tokave bujqësore - Punimi i tokës së fermerëve pranë shtratit të lumit - Shmangia e ndotjes së lumit

<p>3- Ndotja e theksuar e segmentit të shtratit të lumit Devoll që kalon në fshatrat Mançurisht,Cangonj, Progër.</p>	<p>- Ndalimi i hedhjes të mbetjeve urbane në lumin Devoll - Devijimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe të bardha në fshatrat Mançurisht, Progër dhe Cangonj.</p>	<p>** Afatgjatë</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror</p>	<p>10.000.000</p>	<p>- Shmangia e ndotjes se lumit - Ndalimi i fenomenit të erozionit në këto pjesë të lumit Devoll</p>
<p>4 - Rrjeti i kanaleve ujitës - Prishja e kanaleve të rrjetit ujitës</p>	<p>- Pastrimi i kanaleve ujitës dhe kullues - Veshja e skarpateve të tyre në pjesë të veçanta - Hapja e puseve vaditës në toka bujqësore</p>	<p>* Afatmesëm</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror</p>	<p>20.000.000</p>	<p>- Rritja e rendimentit të prodhimit dhe të ardhurave - Rritja e interesit për punimin e tokës</p>
<p>5- Ujërat nëntokësore në pakësim e thellim. - Ushqimi nën mundësitë reale i ujërave nëntokësore prej reshjeve atmosferike.</p>	<p>- Ndalimi i prerjeve të paligjshme në pyje - Parandalimi i zjarreve - Pylëzimi i zonave të dëmtuara dhe pa perspektivë rimëkëmbje</p>	<p>* Afatgjatë</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror - Komuniteti</p>	<p>10.000.000</p>	<p>- Përmirësim në nivelin sasior të ujërave nëntokësore - Parandalimi i erozionit në sipërfaqet e zhveshura pyjore</p>
<p>2 - AJRI</p>					
<p>1- Ndotja e ajrit me gazra të dëmshëm si amoniak, dioksinë, etj.</p>	<p>- Grumbullimi i mbetjeve urbane në vende të caktuara - Grumbullimi i mbetjeve organike dhe trajtimi i tyre jashtë qendrave të banuara - Ndërtimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në fshatrat ku nuk janë ndërtuar</p>	<p>** Afatmesëm</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror - Komuniteti</p>	<p>50.000.000</p>	<p>- Krijimi i një mjedisi dhe ajri me të pastër dhe me të shëndetshëm - Minimizimi i shkaqeve dhe rrezikut për përhapjen e sëmundjeve</p>

<p>2- Ndotja e ajrit nga pluhurat</p>	<p>-Asfaltimi i pjesëve të rrugëve që paraqesin probleme në këtë drejtim - Përmirësimi i teknologjisë në prodhimin e gëlqeres, përfshirë sistemin e kapjes së pluhurave në linjën e prodhimit të inerteve në afërsi të fshatit Progër</p>	<p>*** Afatmesëm</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror - Komuniteti - Biznesi</p>	<p>50.000.000</p>	<p>- Përmirësimi i cilësisë të ajrit në qendrat e banuara - Shmangia e dëmtimeve në sipërfaqet e mbjella apo pemëtove nga pluhuri</p>
<p>3 - TOKA</p>					
<p>1- Gërryerjet dhe prania e fenomenit të erozionit në tokat bujqësore pranë lumit Devoll</p>	<p>- Ndalimi i nxjerrjeve të inerteve nga lumi Devoll - Ndërtimi i pritave dhe mureve mbajtës në vendet e rrezikuara - Pyllëzimi i pjesëve të veçanta të lumit Devoll</p>	<p>* Afatgjatë</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror</p>	<p>20.000.000</p>	<p>- Ndalimi i erozionit të tokave bujqësore pranë lumit - Shfrytëzimi racional i tokave pranë lumit - Përmirësimi i pejsazhit gjate rrjedhës së lumit</p>
<p>2- Pakësimi i tokës bujqësore prej tjetërsimit të saj për ndërtime</p>	<p>- Hartimi i planeve rregullues për fshatrat që nuk kanë të tillë - Ndalimi i ndërtimeve pa leje</p>	<p>* Afatmesëm</p>	<p>- Komuna</p>	<p>2.000.000</p>	<p>- Mbrojtja e sipërfaqes së tokës bujqësore - Krijimi i një infrastrukture të rregullt</p>
<p>3- Përdorim jo racional e abuziv i tokës truall.</p>	<p>- Hartimi i planeve rregullues - Zbatimi i ligjshmërisë urbanistike</p>	<p>** Afatmesëm</p>	<p>- Komuna</p>	<p>2 000 000</p>	<p>- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore - Rrjetëzimi i kanalizimeve të ujrave të zeza - Panoramë e rregullt e qendrave të banuara</p>

4. BIOSFERA					
1- Gjendja e dëmtuar e pyjeve të dushkut si dhe dëmtimet në pishë apo në bredh në afërsi të fshatrave. Prerja abuzive e pyjeve dhe rënia e zjarreve	- Ndalimi i prerjeve abuzive - Parandalimi i rënies së zjarreve - Ndalimi i kullotjes pa kriter - Shtimi i sipërfaqeve të pyllëzuara	*** Afatmesëm	- Komuna - Pushteti qendror - Komuniteti	40.000.000	- Përmirësimi i gjendjes së sipërfaqeve pyjore - Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra -Përmirësimi i punës në rruajtjen dhe mbrojtjen e tërësisë pyjore
2- Mungesa e një bashkërendimi dhe angazhimi për përmirësimin në pyjet e lisit	- Hartimi i projekteve specifike për këtë qëllim - Hartimi i një plani menaxhimi për dhënie në përdorim komunitetit të komunës sipërfaqet pyjore në kuadër të projektit të pyjeve	** Afatshkurtër	- Pushteti qendror	3.000.000	- Përmirësimi i sipërfaqeve pyjore me llojin lis - Rimëkëmbja e sipërfaqeve të degraduara
3- Mosrespektimi i statusit të zonave të mbrojtura prej komunitetit	- Ndërgjegjësimi dhe njohja e komunitetit me statusin e zonave të mbrojtura - Zbatimi i ligjshmërisë në zonat e komunës që gëzojnë këtë status -Qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësisë së strukturave përgjegjëse në administrimi e Zm dhe resurseve ujore.	*** Afatshkurtër	- Komuna - Pushteti qendror - Komuniteti	5.000.000	- Mbrojtje të florës dhe faunës - Përmirësimi i vlerave ekologjike
4- Mungesa e një studimi të plotë për gjendjen aktuale dhe masat për mbrojtjen e llojeve të rrallë dhe atyre të rrezikuar.	- Njohja e komunitetit me këto lloje të rrezikuar dhe me gjerë - Ndërgjegjësim i opinionit	*** Afatmesëm	- Komuna - Shkollat	E pallogaritur	- Rigjenerimi i llojeve të rrezikuar - Mbrojtja e llojeve të tillë

5- Pakësimi në mënyrë të ndjeshme e llojeve që përbëjnë faunën në këtë rajon	-Ndalimi i gjuetisë së paligjshme -Rritje e kontrollit nga organet kompetente	** Afatshkurtër	- Komuna - Pushteti qendror - Komuniteti	E pallogaritur	- Shtimi i popullatave të faunës
5. MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK					
1- Edukimi i pamjaftueshëm mjedisor	- Ngritja e grupeve ekologjike në shkollë - Shtimi i programeve mjedisorë në shkolla	** Afatgjatë	- Komuna - Pushteti qendror - Shkolla - OJQ-t	3.000.000	- Formimi i nxënësve me një edukatë të duhur mjedisorë; - Mbrojtja e vlerave natyrore të zonës
2- Pakesimi i vazhdueshëm i rezervës peshkore nga gjuetia e paligjshme dhe me mjete plasëse	- Zbatimi rigoroz i ligjit - Pastrimi i liqenit te Prespës së Vogël në pjesët e kënetëzuara	* Afatmesëm	- Komuna - Pushteti qendror	50.000.000	- Disiplinimi dhe rregullimi sipas ligjeve në fuqi i aktivitetit të peshkimit, respektimi rigoroz i sezoneve te shtimit - Mbrojtja e llojeve të peshkut në liqenin e Prespës së Vogël
3- Mungesa planeve rregullues në fshatra	- Hartimi i planeve rregullues për çdo fshat	** Afatmesëm	- Komuna - Pushteti qendror	2.000.000	- Ndalimi i ndërtimit pa leje në tokat bujqësore - Rregullimi i infrastrukturës urbane për një mjedis sa më funksional dhe estetik në qendrat e banuara
4- Pamjaftueshmëria e ujit të pijshëm në fshatrat Vranisht, Pilur dhe Rakickë për banorët dhe shkatërrimi i veprave ujëmbajtëse për blegtorinë (lera)	- Ndërtimi i rrjetit shpërndarës - Shfrytëzimi i rregullt i kapaciteteve - Ndalimi i përdorimit të ujit për qëllime vaditje - Meremetimi i lerave për blegtorinë në fshatin Rakickë	** Afatshkurtër	- Komuna - Pushteti qendror - Donatorë	50.000.000	- Rritje nivelit të jetesës - Përmirësimi i shëndetit - Mjedis i pastër dhe higjienik

<p>5- Mungesa e kanalizimit të ujërave të zeza në gjashtë fshatra të komunës me përjashtim të Progrit dhe Pllur</p>	<p>- Përgatitje e projekteve për çdo fshat - Ndërprerja e derdhjes të tyre në lumin Devoll nëpërmjet zgjidhjeve të përbashkëta dhe moderne - Mbulimi i tyre ku ato ekzistojnë</p>	<p>* * * Afatshkurtër</p>	<p>- Komuna - Pushteti qendror - Donatorë</p>	<p>40.000.000</p>	<p>- Krijimi i një mjedisi dhe ajri të pastër - Minimizimi i shkaqeve dhe rënies të sëmundjeve të ndryshme infektive.</p>
<p>6- Ndotja e ajrit nga linjat e prodhimit të inerteve dhe gëlqeres</p>	<p>- Rikonstruksioni i urrave për prodhimin e gëlqers dhe instalimi i sistemit të pluhur kapiës ng firma prodhuese e</p>	<p>* * * Afatshkurtër</p>	<p>- Komuna - Biznesi</p>		<p>- Mënjanimi i rreziqeve për sëmundje - Ndalimi i prishjes të produkteve bujqësore në zonën përreth</p>
<p>7- Mungesa e strategjisë për sigurimin e energjisë nga burime të tjera si era apo panele diellore</p>	<p>- Studimi i kushteve lokale për prodhim energjie nga era dhe dielli (panelet diellore). - Përgatitje e projekteve konkrete</p>	<p>* * Afatgjatë</p>	<p>- Pushteti qendror - Autoritetet vendore - Biznesi</p>		<p>- Rritja e mirëqenies me sigurimin e më shumë burimeve të energjisë - Promovimi i energjive të pastra.</p>

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA PROGER / KESHILLI

Proger me 13.12.2008.

VENDIM Nr 39

Keshilli I Komunes I mbledhur ne daten 13.12.2007. shqyrtoi projektin e Planit Lokal te Veprimit ne Mjedis te paraqitur nga grupi I punes ne bashkepunim me Qendren Rajonale te Mjedisit ne Shqiperi.
Keshilli bazuar ne ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000. neni 10 kapitulli III.
germa a.

VENDOSI

Te miratoje Planin Lokal te Veprimit ne Mjedis per komunen Proger

SEKRETARI

Tasin RUSI



KRYETARI

Gezim GEGOLLI



Local Environmental Action Plan

The Commune of Proger

TABLE OF CONTENTS

VISION	37
I. ASSESSMENT OF CURRENT SITUATION IN THE COMMUNE	39
1.1 Background	
1.1.1 Population	
1.2 Assessment of the natural resources	
1.2.1 Water reserves	
1.2.2 Forests	
1.2.3 Natural resources and biological diversity	
1.3 Human impact	
1.3.1 Urbanization and infrastructure	
1.3.2 Rural development	
1.3.3 Income and business	
1.3.4 Agriculture	
1.3.5 Erosion	
1.3.6 Population health	
1.3.7 Tourism development and environmental education	
II. IDENTIFICATION OF PROBLEMS	47
III. ACTION PLAN	55

VISION

Blessed with a richly diversified environment of vast stretches of agricultural land, with still and running water sources, a varying landscape harmoniously ranging from the field, to the hill, to the mountain, all covered with abundant vegetation thanks to sustainable relationship between the local communities and the environment, the commune of Proger will be able to develop the economy and the culture based on functional infrastructural systems which guarantee adequate living standards constantly on the rise.

1

ASSESSMENT OF CURRENT SITUATION IN THE COMMUNE

1.1 Background

The commune of Proger is located southeast of Albania in the northern part of the Depression of Devoll. It bounds in the north on the commune of Pojan, south on the central commune of Bilisht, east on Greece and west on the commune of Hociisht.

The commune of Proger consists of 8 villages: Proger, Vranisht, Cangonj, Mançurisht, Pilur, Shuec, Rakicke and Bicke. Of these villages, Rakicke, Shuec and Bicke are situated on the mountains. The relief in the territory of the commune is characterized by flat, mount and mountain landscapes.

A part of the Lake of Prespa e Vogel lies in the territory of the commune. Also, the Devoll River runs through the commune. In addition, the area holds a number of other sweet water sources.

The water system of the Lake of Prespa e Vogel (Smaller Prepa) is of both a sensitive and complex nature. Therefore, the integrated management of this system was designed to be one of the key objectives in the administration of the National Prespa Park since its creation. According to the Strategic Action Plan for the Conservation and Sustainable Development of the National Prespa Park which represents the joint objectives of the three partite cooperation over this lake, one of the issues of primordial importance is the full and comprehensive study of the unique peculiarities of the system, in order to design a functional management process to revert or correct to the maximum extent possible the past and recent harmful practices, while establishing effective and efficient management tools and processes. The deviation of the natural bed of the Devoll River to run into the Prespa Lake has been one of those harmful and upsetting interventions whose negative impact has not as yet been fully studied. Neither were the irrigation needs of the field of Korca, for the purpose of which the river was deviated, properly assessed and studied.

The land area is divided into five zones from the third to the fifth category measuring as follows:

- Third category: 304 ha
- Fourth category: 782 ha
- Fifth category: 206 ha
- Sixth category: 395 ha
- Seventh category: 62 ha

1.1.1 Population

The commune of Proger has an overall population of 6060 inhabitants. The average age of the population is 46 years and according to the villages it is as follows:

Village	No. of inhabitants
Proger	1005
Mancurisht	780
Cangonj	1319
Pilur	915
Vranisht	1425
Bicke	171
Rakicke	235
Shuec	210

The post socialist system has seen great population movements both internally and externally. Recently, migration has somehow stabilized and the number of incoming and outgoing families is 3-4 annually.

1.2 Assessment of the natural resources

1.2.1 Water reserves

Amongst the water reserves of the commune of Proger mention can be made of the sources of Mancurisht (water pools), the sources of Proger, the Vranisht River, the fractions of the Lake of Prespa e Vogel falling in the villages of Zagradec and Shuec, as well as the segment of the River of Devoll which crosses the territories of the commune of Proger. The environmental situation of these waters, due to the inefficient administration, following 1976 in particular, has been constantly degrading. The deviation of the river of Devoll to make it flow into the Lake of Prespa e Vogel was the major intervention to the detriment of the environment and its systems. Consequently, the amount of deposit carried into the lake by the river is presently close to catastrophic levels. Vegetation has eaten up the lake's space and water only represents a small surface. The lake's native flora and fauna has also suffered because of the intervention.

Previous assessment of sedimentation deposited into the lake of Prespa e Vogel due to the deviation of the River of Devoll showed an amount of 1.2 million m³.

